



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.133/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, të parashtruar kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 10.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, ZL.Anr.133/2025 datë 08.10.2025.

II. Subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë euro) €uro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largojë posteret e vendosur në sallën e kulturës dhe shtylla, në vendbanimet Donje Korminjane dhe Ropolovë, përkatësisht në komunën e Ranillugut, përndryshe mosbindja ndaj kësaj urdhërese paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

A r s y e t i m

Me datë 08.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.133/2025, ku theksohet se aktivistët e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me datë 7.10.2025, gjatë monitorimit të aktiviteteve të subjekteve të tjera politike, vunë re se përkrahësit e subjektit politik Srpska Lista, në territorin e komunës së Ranillugut, në vendbanimet Donje Korminjane dhe

Ropolovë, kanë vendosur në mënyrë të paligjshme në vende të paautorizuara (salla e kulturës dhe shtylla) posterë, gjë që është në kundërshtim me kodekset e sjelljes për subjektet politike, duke përdorur objekte për promovim dhe duke shkelur rregullat e fushatës zgjedhore, me qenë se kanë ngjitur postera në vende ku nuk parashihet për këtë qëllim. Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi që kanë të bëjnë me ciklin zgjedhor dhe rregullat, duke qenë se shkelja është kryer më 07.10.2025 në orën 14:00, kërkojmë nga PZAP të miratojë këtë ankesë dhe të ndërmarrë masat e mëposhtme, të pranojë ankesën si të themeltë.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotot e posterave të ngjitur nga Lista Serbe në Ranillug.

Subjekti politik Lista Serbe nuk është përgjigjur dhe nuk ka ofruar ndonjë përgjigje lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës, dhe provave të bashkangjitura ankesës, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, janë të qëndrueshme dhe të bazuara, dhe si të tilla i aprovoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik Lista Serbe, ngase e njëjta ka vendosur posterë në vende të paautorizuara, si sallë e kulturës dhe shtylla, në komunën e Ranillugut, në vendbanimet Donje Korminjane dhe Ropolovë, Paneli vlerëson se Lista Serbe me këto veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin përcaktohet se *“Veprimet e ndaluarat të Subjekteve Politike...Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, po ashtu fakti se është përsëritës i shkeljeve të tilla dhe se ky veprim i tyre përbën shkelje të dispozitave të sipërcituara ligjore. Po ashtu, Subjekti Politik, Lista Serbe, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore, prandaj vendosja e posterëve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në objekte publik, sallë e kulturës, dhe shtylla në Ranillug, pa pëlqim të organit kompetent komunal përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, dhe e njëjta shkelje është e sanksionuar me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në të cilin është përcaktuar se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese

janë të qëndrueshme dhe të mbështetura në dëshmi bindëse dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Paneli vlerëson se në rastin konkret Lista Serbe urdhërohet që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë posteret e vendosur në sallën e kulturës dhe shtylla, në vendbanimet Donje Korminjane dhe Ropolovë, përkatësisht në komunën e Ranillugut, ndërsa dështimi për t'iu bindur kësaj urdhëresë të PZAP-it, brenda periudhës së përmendur në vendim, paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1, dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, dhe paragrafi 2, të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.133/2025 datë 10.10.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa